REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Primljeno/Prodato / Received/Delivery		10 · 12 · 2018	
Organi/Njësia / Organ/Jedinica / Org./Unit	Nr.Prot: / Br.Prot: / Prot.No:	Shtojca / Prilog / Appendix	Basta / Kolicina / Quantity
SKPMSHCK	7531/2018		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.696/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Gjylinaze Gola dhe Lulzim Aliaj -anëtarë, Hysni Mustafa, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.696/2018, të datës 29.10.2018.2018, të ankuesit Shkëlqim Jakupi, me adrese banimi rruga Ismail Qemali, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "masë disiplinore " duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.12.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. DETYROHET Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të bëjë shqyrtimin e ankesës me Nr.116-934/3 të datës 31.08.2018, të parashtruar nga ankuesi Shkëlqim Jakupi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

II. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në **pikën I** të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Shkëlqim Jakupi, sipas Ndryshim Plotësimit të Akt emërimit të datës 14.03.2018 është transferuar nga pozita "Drejtor i departamentit për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave" në pozitën "Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave" në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Sekretarja e Përgjithshëm e MAPL-së, me datë 19.07.2018 përmes emalit zyrtar bënë kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor për Shkëlqim Jakupi. Ankuesi Shkëlqim Jakupi është ftuar nga zyra e personelit nëpërmes emalit zyrtar të datës 25.07.2018 për pjesëmarrje në seancën e Komisionit Disiplinorë me pretendimet për shkeljet të rënda–serioze të parashikuara me nenin 12 paragrafi 3.4 të rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Komisioni Disiplinor me datë 06.08.20188 nxjerr vendimin me numër protokolli Nr.116-934 me të cilin i shqiptohet masa disiplinore largim nga pozita e Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Koordinim të Politikave, respektivisht transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme.

Sekretarja e Përgjithshme e MAPL-së me datë 10.08.2018 nxjerr vendimin nr.116-934/2 me të cilin e zbaton vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 06.08.2018 me nr.116-934, duke e transferuar ankuesin Shkëlqim Jakupin në pozitën "Drejtor i Departamentit për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave".

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 06.08.2018, me Nr.116-934, me datë 31.08.2018 ka parashtruar ankesën me Nr.116-934/3, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal edhe përkundër obligimit ligjorë të përcaktuar me dispozitat e nenit 9 paragrafit 7 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, nuk ka vendosur për ankesën me Nr.116-934/3 të datë 31.08.2018 të parashtruar nga ankuesi. Ankuesi me datë 03.08.2018 përmes emalit zyrtar është njoftuar nga Zyra e Personelit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka marr vendim për ankesën e parashtruar nga ankuesi.

Ankuesi i pakënaqur me mos marrjen e përgjigjes nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal brenda afatit ligjor në pajtim me nenit 16 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datë 29.10.2018, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.10.2018, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Më datë 06.11.2018, Këshilli ka pranuar përgjigjen në kërkesë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 29.10.2018 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 6392/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 06.08.2018 me numër protokolli 116-934; Ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të MAPL nr.116-934/3 të datës 31.08.2018; Emali zyrtar i datës 19.07.2018; Emali zyrtar i datës 03.10.2018; Emali zyrtar i datës 02.10.2018; Kërkesa e datës 08.08.2018; Emali zyrtar i datës 06.08.2018; Shkresë e datës 10.08.2018; Emali zyrtar i datës 28.08.2018; Ndryshim plotësimi i akt emërimit i datës 15.08.2018; Emali zyrtar i datës 29.08.2018; Vendimi i datës 16.08.2018; Emali zyrtar i datës 27.08.2018; Vendimi i datës 20.03.2018 për formimin e Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 28.03.2018 për formimin e Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 24.07.2018 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.116-378; Emali zyrtar i datës 25.07.2018; Ftes e datës 09.07.2018; Emali zyrtar i datës 23.07.2018; Procesverbal i datës 25.07.2018; Procesverbal i datës 31.07.2018; Shkresë e datës 23.07.2018; Emali zyrtar i datës 20.06.2018; Vendimi i datës 07.02.2018; Vendimi i datës

16.03.2018; Shkresë e datës 22.06.2018; Emali zyrtar i datës 27.04.2018; Shkresë e datës 27.04.2018; Emali zyrtar i datës 11.06.2018; Emali zyrtar i datës 28.08.2018; Emali zyrtar i datës 18.07.2018; Kërkesa për përgjigje e datës 30.10.2018; Përgjigja në kërkesë e datës 06.11.2018; Emali zyrtar i datës 19.07.2018; Emali zyrtar i datës 18.07.2018; Emali zyrtar i datës 17.07.2018; Emali zyrtar i datës 23.07.2018; Ndryshim plotësimi i akt emërimit për Venera Çerkinin i datës 21.12.2017; Diploma e Venera Çerkinit; Ndryshim plotësimi i akt emërimit për Lumnije Demi; Diploma e Lumnije Demit; Ndryshim plotësimi i akt emërimit për Nikola Aksic; Diploma e Nikola Aksic; Ndryshim plotësimi i akt emërimit për Shkëlqim Jakupin i datës 15.08.2018; Ndryshim plotësimi i akt emërimit për Shkëlqim Jakupin i datës 14.03.2018; Emali zyrtar i datës 01.08.2018; Emali zyrtar i datës 09.08.2018 dhe Emali zyrtar i datës 08.08.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar organin e punësimit, respektivisht Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që ti ndërmarr të gjitha veprimet, për të vendosur lidhur me ankesën me numër protokolli Nr.116-934/3 të datës 31.08.2018 të parashtruar nga ankuesi Shkëlqim Jakupi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil, organet e punësimit janë të obliguara të themelojnë Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për të shqyrtuar dhe vendosur mbi çdo ankesë që paraqitet nga nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil, ashtu siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i MAPL-së, ka qenë i obliguar për shqyrtimin e ankesës me numër Nr.116-934/3 të datës 31.08.2018 të parashtruar nga ankuesi Shkëlqim Jakupi në pajtim me dispozitat e nenit 131, paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: ***"Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative"***, në këtë rast Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i MAPL-së, është i obliguar që të nxjerr vendim në pajtim me procedurat ligjore, duke shqyrtuar afatshmërinë e fillimit të procedimit administrativ nga ankuesi e deri në parashtrimin e ankesës.

Po ashtu kolegji për shqyrtimin e ankesave, në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil, konstatoi se organet e punësimit janë të obliguara të themelojnë Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për të shqyrtuar çdo ankesë që paraqitet nga nëpunësit civil dhe aplikuesit për punësim në shërbimin civil, ashtu siç parashihet me nenin 82 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se ***„Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës".***

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.696/2018 me datën 06.12.2018

Malsore GASHI BAJRAKTARI
Kryesuese e Kolegjit

Hysni Mustafa
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit, Shkëlqim Jakupi;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;*
- *Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*